



---

**Hapet thirrja për mobilitete studentësh të UPT-së,  
për semestrin e dytë të vitit akademik 2023 - 2024  
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107  
në University of Salento (UNISALENTO), Itali.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe University of Salento, hapet thirrja për mobilitete për studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of Salento.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:** Shkëmbimin e studentëve për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:** Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi të Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe të kenë përfunduar vitin e parë të studimeve.

**Fushat e studimit:** Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

**Kohëzgjatja e bursës:** Semestri i II i vitit akademik 2023 - 2024

**Numri total i studentëve:** 2

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj\* (Italisht ose English);
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është: Italian-B1; English-B1.*

*Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate, etj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në UNISALENTO lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement", ju lutemi klikoni te:*

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**



---

Për t'u njohur me listën e lëndëve të ofruara nga UNISALENTO, ju lutemi klikoni te:

[Course Catalogue - International - University Of Salento \(unisalento.it\)](https://www.unisalento.it)

**Duke u inkurajuar edhe nga politikat sociale të University of Salento, përparësi do të kenë studentët me aftësi të kufizuara dhe studentët me probleme sociale.**

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

**Deri më 20 nëntor 2023, ora 12.00**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email:  
[smaraj@fti.edu.al](mailto:smaraj@fti.edu.al) , [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) , [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)